

## "Ta pastrojmë Shqipërinë!"

### Konteksti

Instituti Kërkimeve Urbane ka ofruar asistencë teknike dhe ka ndihmuar në lehtësimin e procesit të mobilizimit të komunitetit në kuadër të projektit "Ta pastrojmë Shqipërinë".

Përgjatë periudhës së zbatimit të projektit, mars – maj 2018, IKU është angazhuar në hartimin e planeve të punës si dhe kalendarëve të aktiviteteve për bashkitë Shkodër, Lezhë dhe Pukë, dakortësuar me kryetarët e bashkive. Gjithashtu, ka bashkëpunuar me zyrtarët e bashkive në organizimin dhe promovimin e aktiviteteve në media lokale, media sociale si dhe ka qenë e pranishme në disa prej aktiviteteve të zbatuara në tre bashkitë e përfshira në projekt.

### Treguesit e arritur

Në kuadër të këtij projekti bashkitë kanë organizuar aktivitete të cilat ndihmojnë në rritjen e sensibilizimit qytetar për mbrojtjen e mjedisit si dhe në reduktimin e mbetjeve në zona të caktuara. Bazuar në buxhetin që bashkitë kanë pasur të përcaktuar ato kanë arritur që nëpërmjet këtij projekti të arrijnë rezultatet si më poshtë:

**Bashkia Shkodër** ka përfshirë më shumë se 600 nxënës dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme në aksionet e pastrimit realizuar në kuadër të projektit duke siguruar në këtë mënyrë pastrimin e akseve më të rëndësishme në bashki dhe gjithashtu realizimin e pastrimit të zonës përreth dhe brenda Kalasë së Shkodrës. Bashkia ka realizuar dhe orë edukative duke përfshirë dhe



shfaqje të filmave Mjedisor me synim ndërgjegjësim të qytetarëve, dhe specifikisht nxënësve të shkollave 9-vjeçare.

**Bashkia Lezhë** në përfundim të këtij projekti ka grumbulluar dhe zhvendosur 86.5 ton mbetje. Gjatë aktiviteteve të pastrimit në këtë bashki janë përfshirë rreth 1500 persona përfaqësues të institucioneve që u përfshinë në organizimin e projektit por edhe nxënës të shkollave. Nëpërmjet angazhimit të disa aktorëve realizohet shtrirja e informacionet rreth këtyre aktiviteteve si dhe rritja e ndërgjegjësimit në një shkallë të gjerë.

**Bashkia Pukë** ka mbjellë 36 pemë dekorative dhe janë grumbulluar dhe zhvendosur 5 ton mbetje. Ndërkohë, në realizimin e aktiviteteve të pastrimit janë përdorur 4000 copë qese për mbledhjen e mbetjeve dhe 2000 palë Doreza, 10 kova për lyerjen e pemëve dekorative, 10 furça për lyerje, 500 kg gëlqere për lyerje ku rezultojnë se janë lyer të gjitha trungjet e pemëve dekorative në qytetin e Pukës.

### FAKTET KRYESORE

#### DONATOR:

dldp

#### PARTNERË:

- Bashkia Shkodër
- Bashkia Lezhë
- Bashkia Pukë

#### KOHËZGJATJA:

1 Mars 2018 – 31 Maj 2018

#### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtor Ekzekutiv

Instituti i Kërkimeve Urbane  
Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: info@uri.org.al  
web: www.uri.org.al

### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnim të njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.